



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Pranuesi Received/Delivered	04.08.2023	3	viti year
Organ /Njësia Organ /Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojza Prilog Appendix	Sasia Koliciteti Quantity
SKRIPSHICK	5539/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.846/2023

Këshilli i Pavarur M b ikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Vjollca Sinani - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbaitëses, në lidhje me ankesën A.nr.846/2023 të datës 15.06.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi rr. _____ nr.36, Prishtinë, kundër organit të punësimit Agjencia Pyjor e Kosovës , në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si i bazuar ankesa me numër A.nr.846/2023 e datës 15.06.2023 e parashtruar nga ankuesi _____, në atë mënyrë që aprovohet si i bazuar pretendimi lidhur me Vendimin Ref:KE-333/2023 të datës 09.06.2023 të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës,ndërsa refuzohet pretendimi ankimor lidhur me vendimin numër DQIPGJ 156/23 të datës 26.05.2023 të Udhëheqësit të Sektorit për Inspektim në Pylltari- DQIPGJ. .

II. Shfuqizohet Vendimi për ndalesë në pagë, me numër Ref:KE-333/2023 i datës 09.06.2023 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, mbetet në fuqi vendimi DQIPGJ 156/23 i datës 26.05.2023 i Udhëheqësit të Sektorit për Inspektim në Pylltari-DQIPGJ lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me shkrim".

III. Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimi të vendimit, ankuesit ti kompensoj shumën në vlerë prej 4.24 euro, të ndaluar në pagë sipas Vendimit me numër Ref: KE-333/2023 të datës 09.06.2023.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] në pozitën e punës sipas Akt emërimit me protokoll ZPD:280/2013 të datës 31.12.2013 në pozitën "Inspektor për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunim të drurit" në Drejtorin e Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë në Agjencia Pyjor e Kosovës, më datë 15.06.2023 parashtron ankesë me numër protokollit 4746/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër Vendimit DQIPGJ,156/23 të datës 26.05.2023 të Agjencisë Pyjore të Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me Shkrim" për ankuesin nga Udhëheqësi i Sektorit për Inspektim në Pylltari, DQIPGJ si dhe Vendimit me numër Ref:KE-333/2023 të datës 09.06.2023 për ndalesë në pagë, nga se sipas pretendimit ankimor kemi të bëjmë me konstatim të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve të dispozitave ligjore, shkeljeve të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe shkeljeve të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative me rastin e

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit te organi i punësimit, ndërsa ky i fundit më datë 22.06.2023 ka dërguar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.07.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokollit 5356/2023 për shtyrjen e afatit të vendosjes së ankesës së ankuesit për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4746/2023 të datës 15.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimit me DQIPGJ,156/23 të datës 26.05.2023 Agjencia Pyjor e Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore të lehtë "Vërejtje me Shkrim" për ankuesin nga Udhëheqësi i Sektorit për Inspektim në Pylltari, DQIPGJ; Vendimit me numër Ref:KE-333/2023 të datës 09.06.2023; Shkresë nga inspektorët e pyjeve; Evidenca e ardhjes në punë e datës 22.05.2023; Evidenca e ardhjes në punë e datës 22.05.2023; Email i datës 05.06.2023; Email i datës 22.05.2023; Përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e lëndës e datës 22.06.2023; Përgjigje në ankesë nga Agjencia Pyjor e Kosovës; Akt emërimi i XH.B; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën e ankuesit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022; Email i datës 12.01.2023, Vendim me numër protokollit 5356/2023 për shtyrjen e afatit të vendosjes i datës 26.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, sipas Akt emërimit ZPD:280/2013 të datës 31.12.2013 në pozitën "Inspektor

për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunim të drurit” në Drejtorin e Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Udhëheqësi i Sektorit për Inspektim në Pylltari me Vendimin DQIPGJ -156/23 të datës 26.05.2023, ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore “Vërejtje me shkrim”, me arsyetimin se i njëjti me datë 22.05.2023 është nënshkruar në formularin e evidencës së ardhjes në punë në ora tetë (8) e që në fakt deri në ora tetë e dyzetepesë (8:45) minuta ka qenë në restorantin “Mamas” pa leje nga Udhëheqësi i drejtpërdrejt, përkundër se për një gjë të tillë iu ishte tërhequr vërejtja përmes e-mailit zyrtar të datës 12.01.2023 nga Drejtori i Drejtoratit Qendror të Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti duke e paralajmëruar se kjo është vërejtja e fundit e cila ju tërhiqet dhe nuk ndërmerren masa disiplinore.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë poashtu se Drejtori Ekzekutiv i APK-së bazuar në kërkesën e Drejtorit të DQIPGJ të datës 25.06.2023 ka nxjerrë Vendimin Ref. KE-333/2023 të datës 09.06.2023 për ndalesë në pagë për ankuesin në vlerën prej 4.24 euro për shkak të mungesës së një ore pune në muajin maj 2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ka shqiptuar “Vërejtje me shkrim” kinse për mosrespektimin e orarit të punës nga ora 08:00 -08:45, ndërsa i njëjti nuk ishte prezent gjatë kësaj kohe. Duke theksuar se ndalesa e pagës sipas Vendimit Ref. KE-333/2023 të datës 09.06.2023, është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë referuar procedurës disiplinore të nëpunësve civilë përkatësisht nenin 45 më të cilin përcaktohet se: “Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore dergjët veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se nëpunësi civil mbanë përgjegjësi disiplinore në rastet kur vërtetohet se i njëjti me veprimet ose mosveprimet e tij ka shkelur dispozitat e ligjit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësit e punës dhe mbi bazën që të jenë plotësuar në mënyrë komulative elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht edhe organi kompetent publik me rastin e vendosjes lidhur me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të nëpunësve civil është i obliguar që të veprojë në pajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë, mosdiskriminimit, objektivitetit, paanësisë, pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, si dhe parimin e informimit dhe ndihmës aktive siç është përcaktuar me nenin 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, dhe 11 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Duke marrë përsysh natyrën e shkeljes disiplinore, Kolegji iu referua edhe Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, përkatësisht nenin 9 më të cilin është përcaktuar: “Respektimi i orarit të punës 1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës. 2. Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni. 3. Mos

regjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mos prezencë në punë. 4. Përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik, është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore. 6. Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë”.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë, e duke u bazuar në analizimin e provave materiale, Kolegji ka konstatuar se ankuesi përkundër se me emailin zyrtar të datës 12.01.2023 të Drejtorit të DQIPGJ-së, ishte paralajmëruar për mos respektim të orarit të punës, i njëjti më datë 22.05.2023 ishte nënshkruar në evidencën e ardhjes në punë në ora 8:00, mirëpo ankuesi nuk kishte qenë prezent në vendin e punës deri në ora 8:45 dhe se për këtë mos prezencë nuk kishte leje nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, kështu që në vlerësimin e Kolegjit ankuesi me këto veprime ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 9 të Rregullores(QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, andaj, pretendimi ankimor lidhur me kundërligjshmërinë e vendimit për shqiptimin masës disiplinore “Vërejtje në shkrim” është i pa bazuar. Rrjedhimisht, Udhëheqësi i Sektorit Për Inspektim në Pylltari në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankueses ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit si shkelje të lehtë disiplinore dhe drejtë ka zbatuar ligjin material me rastin e shqiptimit të masës disiplinore të atakuar me ankesë.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor përkitazi me kundërligjshmërinë e Vendimit për ndalesë në pagë me numër Ref:KE-333/2023 i datës 09.06.2023 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, Kolegji konstaton se ndaj nëpunësit civil në rast të konstatimit të përgjegjësie disiplinore mund të shqiptohen vetëm masat disiplinore siç përcaktohet me nenin 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku thuhet se: *Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil.* Rrjedhimisht mbi këtë përcaktim ligjor dhe duke iu referuar nenit 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji konstaton se për shkelje të lehta disiplinore kompetent është udhëheqësi i nëpunësit civil dhe masa e vetme disiplinore që mund të shqiptohet për shkelje të tilla është masa disiplinore “Vërejtje”, andaj mbi këtë bazë rrjedhë se ndalesa në pagë për ankuesen sipas Vendimit Ref: KE-333/2023 të datës 09.06.2023 të Drejtorit Ekzekutiv të APK-së nuk është veprim i lejuar me dispozita materiale në fuqi dhe nuk është i kualifikuar si masë disiplinore, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë është ligjërisht i drejtë.

Bazuar në at që u tha më lartë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS FËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.846/2023, datë 04/08/2023

Vjollca Sinani

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjor të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

